VENDIM
Nr. 782, datë 22.9.2015

Për MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË DHE ANËTARËVE TË TJERË TË NISMËS PËR REFORMËN ARSIMORE TË EVROPËS JUGLINDORE (ERI SEE), PËR SELINË E SEKRETARIATIT TË ERI SEE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Serbisë dhe anëtarëve të tjerë të Nismës për Reformën Arsimore të Evropës Juglindore (ERI SEE), për selinë e sekretariatit të ERI SEE, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË DHE ANËTARËVE TË TJERË TË NISMËS PËR REFORMËN ARSIMORE TË EVROPËS JUGLINDORE (ERI SEE) PËR SELINË E SEKRETARIATIT TË ERI SEE

Anëtarët e Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore (më poshtë e quajtur ERI SEE) si Palë në këtë Marrëveshje (më poshtë të quajtura "Palët");

bazuar në angazhimet e Memorandumit të Mirëkuptimit mbi Rolin dhe Organizimin e Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore (ERI SEE), të nënshkruar në Brdo, Slloveni më 5 qershor 2010 nga ministrat përgjegjës për arsimin dhe arsimin e lartë të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Malit të Zi dhe Republikës së Serbisë, me pjesëmarrjen e të ftuarve të veçantë: një përfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (KBR-RCC) dhe Kryetari i KBR, Task Force për Edukimin e dhe Krijimin e Kapitalit Njerëzor (TKEKKN), Republika e Moldavisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, që aderuan në Memorandumin e Mirëkuptimit nëpërmjet protokolleve të nënshkruara përkatësisht nga ministrat përkatës të arsimit dhe kryetari i ERI SEE, më 27 dhjetor 2010 dhe 11 mars 2011 (më poshtë i quajtur "Memorandumi i Mirëkuptimit MM)";

duke marrë në konsideratë se Memorandumi i Mirëkuptimit parashikon krijimin e Sekretariatit të ERI SEE me seli në një nga Vendet Anëtare të ERI SEE;

duke rikujtuar vendimin unanim të Bordit Drejtues për të pranuar propozimin e Republikës së Serbisë për të caktuar Beogradin si selinë e re të Sekretariatit të ERI SEE-së;

me dëshirën për të rregulluar privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për mbarëvajtjen dhe realizimin me sukses të misionit të Sekretariatit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) "Vendi pritës" do të quhet Republika e Serbisë;

b) "Qeveria e vendit pritës" do të quhet Qeveria e Republikës së Serbisë;

c) "Sekretariat" do të quhet Sekretariati i Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore;

d) "Drejtori i Sekretariatit" do të quhet një person i caktuar si drejtor i Sekretariatit të Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore;

e) "Anëtar stafi" do të quhet një anëtar i stafit të Sekretariatit që kryen detyra me kohë të plotë në

Sekretariat, duke përjashtuar ato të përcaktuara në nënparagrafin "j" dhe "k" të këtij neni;

f) "Staf ndërkombëtar" do të quhet një anëtar stafi, i cili nuk është as shtetas i Republikës së Serbisë, as shtetas i huaj me banim të përhershëm në Republikën e Serbisë;

g) "Stafi (i rekrutuar) vendas" do të quhet një anëtar stafi, shtetas i Republikës së Serbisë, ose një shtetas i huaj me banim të përhershëm në Republikën e Serbisë;

h) "Anëtar familjeje" do të quhen një bashkëshort/e dhe fëmijët në varësi deri në moshën 26 vjeç, me kusht që ata të jetojnë në Republikën e Serbisë në të njëjtën shtëpi me anëtarët e stafit të Sekretariatit, dhe të mos jenë as shtetas të Republikës së Serbisë, as shtetas të huaj me banim të përhershëm në Republikën e Serbisë;

i) "Godina e Sekretariatit" do të quhen godina, duke përfshirë tokën mbi të cilën ndodhet ndërtesa e zënë nga Sekretariati dhe që përdoret vetëm për qëllimet e Sekretariatit, pavarësisht pronësisë së përcaktuar në shtojcën 1;

j) "Ekspert" do të quhet një person që kryen një detyrë të përkohshme për Sekretariatin, përveç veprimtarive të përcaktuara në nënparagrafët "e" dhe "k" të këtij neni;

k) "Përfaqësues" do të quhet një përfaqësues i autorizuar i një anëtari të Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore;

l) "Statut" do të thotë Statuti i Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore;

m) "Bordi Drejtues" do të quhet Bordi Drejtues i Nismës së Reformës Arsimore të Evropës Juglindore.

Neni 2

Selia

1. Sekretariati themelohet nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje. Selia e Sekretariatit do të jetë në Beograd, Republikën e Serbisë.

2. Qeveria e vendit pritës do t'i ofrojë falas Sekretariatit godinën, ndihmë komunikimi dhe logjistike, siç është përcaktuar në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje, të nevojshme për përmbushjen efektive të funksioneve të saj në përputhje me parashikimet e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Statusi ligjor

1. Sekretariati do të ketë personalitetin ligjor dhe cilësinë juridike të nevojshme për të kryer funksionet e tij në mënyrë që të lidhë kontrata, të blejë dhe të shesë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të kryejë procedime ligjore në përputhje me legjislacionin e vendit pritës.

2. Vendi pritës do të lehtësojë procedurat e marrjes së dokumenteve të përshtatshme me qëllim rregullimin e statusit ligjor të Sekretariatit.

Neni 4

Kontributi financiar

1. Palët marrin përsipër të ofrojnë kontributet e tyre financiare vjetore për buxhetin vjetor të Sekretariatit në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit, në veçanti shtojcën 3 të Memorandumit, bashkëlidhur si shtojca 2 për lehtësi referimi.

2. Pas përfundimit të periudhës së parashikuar në shtojcën 3 të Memorandumit të Mirëkuptimit, ose në rast aderimesh të reja, Palët do të sigurojnë kontributet e tyre financiare në përputhje me vendimet e Bordit Drejtues, ashtu siç parashikohet në Statut.

3. Përveç kontributit financiar vjetor, në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit, shtojca 3, vendi pritës do të sigurojë një kontribut financiar shtesë mbi një bazë vjetore për shpenzimet operative të Sekretariatit të përcaktuara në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Rregullat ndërkombëtare

1. Sekretariati mund të miratojë rregulla të brendshme të nevojshme për zbatimin dhe organizimin e funksioneve të tij, në përputhje me Statutin.

2. Sekretariati do të informojë autoritetet kompetente të vendit pritës mbi rregullat e brendshme përkatëse.

Neni 6

Logoja dhe emërtimet

1. Sekretariati mund të ekspozojë flamurin, logon dhe simbole të tjera në godinën e tij dhe mbi mjetet motorike të Sekretariatit.

2. Mjetet motorike të Sekretariatit do të kenë të drejtën e regjistrimit diplomatik dhe statusit përkatës.

Neni 7

Imuniteti nga procesi gjyqësor dhe detyrimi

1. Sekretariati do të gëzojë imunitet nga procesi gjyqësor, gjyqësori dhe nga ndonjë detyrim tjetër që zbatohet në vendin pritës, përveçse në rast se paraqitet një kundërpretendim i lidhur drejtpërsëdrejti me pretendimin e ngritur nga Sekretariati ose në rastin kur Bordi Drejtues ka hequr dorë qartë nga ky imunitet. Megjithatë, vetëkuptohet që një heqje e tillë e imunitetit nuk do të zbatohet për çdo masë detyruese. Heqja e imunitetit si masë detyruese duhet të jepet në mënyrë të qartë.

2. Pa cenuar paragrafin 1 të këtij neni, Sekretariati do të përpiqet të zgjidhë nëpërmjet negociatave, ose nëse negociatat dështojnë, atëherë nëpërmjet zgjidhjeve alternative të konflikteve, të gjitha kontradiktat që lindin nga:

a) ndonjë kontratë për blerje mallrash dhe shërbimesh, ndonjë hua apo transaksione bankare që synojnë financim, si dhe ndonjë marrëdhënie garancie apo dëmshpërblimi në lidhje me ndonjë transaksion apo ndonjë detyrim tjetër financiar;

b) Mosmarrëveshjet në punë.

Në rast se mosmarrëveshjet lidhur me çështjet e trajtuara në paragrafin 2, nënparagrafët "a" dhe "b", nuk mund të zgjidhen përmes negociatave, gjykata përkatëse e vendit pritës do të jetë përgjegjëse për zgjidhjen e tyre. Mosmarrëveshjet do të zgjidhen në përputhje me ligjet e vendit pritës.

3. Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Sekretariatit, të kudondodhura dhe të poseduara nga kushdo në vendin pritës, do të gëzojnë imunitet nga ndonjë masë detyruese, përfshirë konfiskimin, marrje me forcë, ngrirje ose çdo formë tjetër detyrimi, konfiskimi apo shpronësimi, të parashikuara nga ligjet e vendit pritës.

Neni 8

Paprekshmëria e sekretariatit

1. Godina dhe prona e Sekretariatit janë të paprekshme.

2. Vendi pritës duhet të garantojë që selia e Sekretariatit të jetë e pacenueshme. Autoritetet kompetente të vendit pritës do të kenë të drejtë të hyjnë në ambientet e Sekretariatit për kryerjen e detyrave të tyre, vetëm me pëlqim të drejtorit të Sekretariatit ose të një zyrtari të autorizuar të Sekretariatit, sipas kushteve të rëna dakord mes tyre. Megjithatë, në rast zjarri ose emergjencash të ngjashme, një pëlqim i tillë do të konsiderohet i dhënë nëse kërkohen masa mbrojtje jetë menjëhershme.

3. Dokumentet dhe materialet arkivore të Sekretariatit, duke përfshirë gjithë aplikimet kompjuterike dhe fotografitë që i përkasin atij ose janë pronë e tij, janë të paprekshme.

4. Qeveria e vendit pritës do të ndërmarrë të gjitha masat për të ruajtur godinën e Sekretariatit kundër çdo ndërhyrje apo dëmtim, shqetësim apo shkelje të dinjitetit të Sekretariatit.

Neni 9

Publikimet

Importi dhe eksporti i publikimeve, si dhe i çdo materiali tjetër informues i importuar apo eksportuar nga Sekretariati për përdorimin e tij zyrtar, nuk do të t'i nënshtrohet asnjë lloj kufizimi.

Neni 10

Përdorimi i fondeve

Sekretariati, me qëllim kryerjen e funksioneve të tij, do të ketë të drejtë të marrë, të mbajë, të shkëmbejë, të transferojë të gjitha fondet, monedhat, para në dorë (kesh) dhe të heqë ato lirisht, në përputhje me rregullat e vendit pritës. Kjo e drejtë do të përfshijë, por nuk do të kufizojë, të drejtën për të mbajtur një llogari jorezidenciale në një bankë biznesi në vendin pritës.

Neni 11

Shërbimet e nevojshme

1. Autoritetet kompetente të vendit pritës, me kërkesë të Sekretariatit, do t'i sigurojnë atij shërbimet e nevojshme me qëllim kryerjen e funksioneve të tij.

2. Çmimet për shërbimet e nevojshme të përmendura më sipër, që nuk janë objekt i shtojcës 1, nuk do t'i tejkalojnë çmimet më të ulëta të krahasueshme me ato të miratuara për misionet diplomatike.

3. Me kërkesë të autoriteteve kompetente të vendit pritës, drejtori i Sekretariatit duhet t'u kërkojë qasje përfaqësuesve të autorizuar prej kompanive të shërbimit, për të kontrolluar, riparuar, mbajtur ose për të zhvendosur instalimet në godinën e Sekretariatit sipas nevojës, me kusht që kjo të mos cenojë funksionimin e Sekretariatit.

Neni 12

Përjashtimet nga detyrimet dhe taksat

1. Sekretariati, pasuritë e tij, të ardhurat dhe pronat e tjera do të përjashtohen nga taksat kombëtare dhe vendore. Ky përjashtim nuk do të zbatohet për taksat dhe përvetësimet të cilat konsiderohen si pagesa për shërbimet të nevojshme, të ofruara sipas normave të vendosura, sipas sasisë së shërbimeve të kryera, të cilat mund të identifikohen, përshkruhen dhe ndahen.

2. Në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar e përfshirë në çmime apo për t'u paguar veçmas, përjashtime do të bëhen vetëm për sasi të arsyeshme të artikujve të blerë dhe shërbimeve të kryera për përdorim zyrtar nga Sekretariati, në këtë rast mallrat e blera për përdorimin e tij, për të cilat zbatohen përjashtime nga taksat në përputhje me këtë masë, nuk mund të shiten, të falen ose të përdoren në ndonjë mënyrë tjetër, përveç se sipas kushteve për të cilat është rënë dakord me qeverinë e vendit pritës.

Neni 13

Përjashtimi nga detyrimet e importit

1. Sekretariati do të ketë të drejtën të importojë pa paguar taksa doganore sasi të arsyeshme mallrash për përdorimin e tij zyrtar, duke përfshirë mjetet motorike.

Neni 14

Sigurime shoqërore

1. Drejtori dhe anëtarët e stafit të Sekretariatit, me kusht që ata të jenë staf ndërkombëtar, do të përjashtohen nga pagesa e kontributeve të detyrueshme për çdo lloj sigurimi shoqëror në vendin pritës.

2. Drejtori dhe anëtarët e stafit të Sekretariatit, me kusht që ata të jenë staf vendas, do të jetë subjekt i kontributeve të detyrueshme në përputhje me legjislacionin e Republikës së Serbisë.

Neni 15

Drejtori i Sekretariatit

1. Gjatë tërë mandatit të tij në vendin pritës, drejtorit të Sekretariatit do t'i ofrohen të njëjtat privilegje si për shefat e zyrave të ngjashme të organizatave ndërkombëtare në vendin pritës.

2. Drejtori, i cili është anëtar i stafit ndërkombëtar, gëzon imunitetet dhe privilegjet e parashikuara në nenin 16 më poshtë.

3. Pa cenuar paragrafin 1 të këtij neni, drejtori, një punonjës vendas nuk do të gëzojnë asnjë imunitet apo privilegj mbështetur në këtë marrëveshje, duke përfshirë imunitet nga procedimi gjyqësor për veprime të kryera gjatë zbatimit të detyrave të tyre, përfshirë fjalë të thëna apo të shkruara.

Neni 16

Privilegjet dhe imunitetet e stafit ndërkombëtar

1. I gjithë stafi ndërkombëtar do të gëzojë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme në vendin pritës:

a) Imunitet juridik për veprime të kryera gjatë zbatimit të funksioneve të tyre, përfshirë fjalët e thëna apo shkruar prej tyre edhe kur ata nuk punojnë më për Sekretariatin;

b) Imunitet nga kërkimi dhe konfiskimi i bagazhit të tyre personal;

c) Përjashtim nga taksat dhe kontributet mbi pagat, shpërblimet dhe kompensimet, që Sekretariati u ka paguar atyre për shërbimet e kryera;

d) Përjashtimi nga TVSH-ja për sasi të arsyeshme mallrash dhe shërbimesh për përdorim personal të anëtarëve të stafit në përputhje me legjislacionin e vendit pritës;

e) Përjashtimi nga kufizimet e emigracionit dhe detyrimit për të regjistruar veten dhe anëtarët e tyre të familjes që janë pjesë e familjeve të tyre në përputhje me regjimin e vizave të vendit pritës;

f) E njëjta mbrojtje dhe lehtësi riatdhesimi për veten dhe anëtarët e familjeve të tyre, siç u është dhënë zyrtarëve në nivel të krahasueshëm në misionet diplomatike;

g) E drejta për të importuar për përdorim personal, pa paguar detyrime importi apo taksa të tjera, me kusht që këto të mos jenë taksa për kryerjen e shërbimeve të nevojshme, si dhe përjashtim nga pengesat e importit dhe kufizimet e import-eksportit:

i) mobiliet dhe sendet personale që në momentin marrjes së detyrës, në një apo më shumë ngarkesa,

ii) një mjet motorik.

Neni 17

Stafi i punësuar në vend

1. Stafi i rekrutuar në vend do të punësohet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të vendit pritës.

2. Stafi i rekrutuar në vend, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të gëzojë imunitet apo privilegj, përfshirë imunitet nga procedimi gjyqësor për veprime të kryera gjatë zbatimit të detyrave të tyre, duke përfshirë fjalë të thëna apo të shkruara.

Neni 18

Ekspertët

Ekspertët, nëse nuk janë shtetas të vendit pritës ose shtetas të huaj me vendbanim të përhershëm në vendin pritës, do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) Imunitet nga juridiksioni gjyqësor për veprimet e kryera gjatë zbatimit të detyrave të tyre, duke përfshirë fjalë të thëna apo shkruara në funksionin e tyre zyrtar;

b) Paprekshmëria e gjithë letrave zyrtare, të dhëna mediatike dhe dokumenteve në përputhje me procedurat në fuqi;

c) Përjashtim nga kufizimet e emigracionit në përputhje me rregullat e vendit pritës.

Neni 19

Përfaqësuesit

Përfaqësuesit, nëse nuk janë shtetas të vendit pritës apo shtetas të huaj me banim të përhershëm në vendin pritës, gjatë periudhës së kryerjes së detyrave të tyre në vendin pritës, si dhe gjatë udhëtimeve të tyre në këtë territor, do të gëzojnë privilegjet e mëposhtme:

a) Imunitet nga juridiksioni për veprimet e kryera gjatë zbatimit të detyrave të tyre, duke përfshirë fjalë të thëna apo shkruara në funksionin e tyre zyrtar;

b) Përjashtime nga kontrolli dhe sekuestrimi i bagazheve personale;

c) Paprekshmëria e dokumenteve zyrtare, të dhënave dhe materialeve të tjera;

d) Përjashtime nga kufizimet e emigracionit në përputhje me rregullat e vendit pritës.

Neni 20

Përjashtime nga imuniteti

Anëtarët e stafit, ekspertët dhe përfaqësuesit nuk do të gëzojnë imunitet në lidhje me çdo veprim që lidhet me shkeljen e rregullave të qarkullimit.

Neni 21

Heqja dorë nga imuniteti

1. Privilegjet dhe imunitetet nuk do t'i jepen për përfitim personal individëve, por për të siguruar funksionimin efikas të Sekretariatit, në përputhje me qëllimet e tij.

2. Bordi Drejtues do të ketë të drejtë dhe detyrim të heqë imunitetin për çdo anëtar të stafit të Sekretariatit në çdo rast ku, sipas mendimit të tij imuniteti do të pengojë zbatimin e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesin e nismës ERI SEE ose të Sekretariatit. Heqja e imunitetit nga juridiksioni gjyqësor duhet të jepet gjithmonë me shkrim.

3. Heqja e imunitetit nga juridiksioni gjyqësor në përputhje me procedurat administrative nuk do të bëhet për të hequr imunitetin, me qëllim zbatimin e vendimit gjyqësor për të cilin do të jetë i nevojshëm një

dokument i veçantë heqje imuniteti.

Neni 22
Njoftimi

1. Sekretariati do t'i ofrojë Protokollit Diplomatik të Ministrisë të Punëve të Jashtme të vendit pritës:

a) Listën e stafit ndërkombëtar dhe të anëtarëve të tyre të familjes që janë pjesë e familjeve të tyre përkatëse, menjëherë ose të paktën brenda tre ditësh nga data e mbërritjes së tyre;

b) Sekretariati gjithashtu duhet të njoftojë mbi përfundimin e detyrës të çdo stafi ndërkombëtar sipas pikës "a", dhe sipas nevojës, nëse një person pushon së qeni anëtar i një familjeje përkatëse.

2. Stafi ndërkombëtar që është paraqitur në përputhje me paragrafin e mëparshëm, pajiset me dokumentacionin e duhur të identifikimit nga Protokolli Diplomatik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Serbe.

Neni 23
Përgjegjësia e vendit pritës

Vendi pritës nuk do të jetë përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e kryera nga Sekretariati dhe stafi i tij brenda territorit të tij.

Neni 24
Çështjet e sigurisë

1. Në këtë Marrëveshje asgjë nuk do të përjashtojë të drejtën e qeverisë së vendit pritës të marrë masat e duhura mbrojtëse në interes të sigurisë publike apo të ndalojë zbatimin e ligjeve të saj, të cilat janë të nevojshme për ruajtjen e rendit dhe shëndetit publik.

2. Nëse qeveria e vendit pritës e çmon të nevojshme zbatimin e masave të parashikuara në paragrafin 1 më lart, kur rrethanat e lejojnë, ajo do të kontaktojë Sekretariatin në mënyrë që të marrin një vendim të përbashkët mbi masat që mund të jenë të nevojshme për të mbrojtur interesat e Sekretariatit.

3. Sekretariati do të jetë i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet e vendit pritës për të shmangur çdo dëmtim të sigurisë publike që shkaktohet si rezultat i aktivitetit të Sekretariatit.

Neni 25
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet, për sa i përket zbatimit dhe interpretimit të kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen përmes negociatave ndërmjet Palëve.

Neni 26
Amendamentet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqim të ndërsjellë të Palëve. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 27 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 27
Hyrja në fuqi, kopjet origjinale dhe depozitari

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Ministria e Punëve të Jashtme e vendit pritës merr njoftimin e katërt nga Palët, duke përfshirë edhe vendin pritës, pasi të jenë përfunduar procedurat e brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi.

2. Për secilën Palë, e cila, pas depozitimit të njoftimit të katërt në përputhje me nenin 1, njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme të vendit pritës për plotësimin e procedurave të saj të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, ajo do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit bërë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

3. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes, origjinali do të depozitohet pranë qeverisë së vendit pritës, e cila do të shërbejë si depozitari. Depozitari do t'u ofrojë Palëve të Marrëveshjes dhe Sekretariatit kopje të noterizuara të saj.

4. Kjo Marrëveshje do të zbatohet përkohësisht që nga data e nënshkrimit të saj. Secila Palë mund të deklarojë në momentin e nënshkrimit se Marrëveshja do të zbatohet që nga data e përfundimit të procedurave përkatëse të brendshme për hyrjen e saj në fuqi.

Neni 28

Vlefshmëria, pezullimi, aderimi, anulimi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar kohe.

2. Një Palë tjetër aderuese në Memorandumin e Mirëkuptimit gjithashtu do të aderojë në këtë Marrëveshje, në përputhje me dispozitat e nenit 27 të kësaj Marrëveshjeje.

Qeveria e vendit pritës do të ketë të drejtë ta anulojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar Palët me shkrim për këtë qëllim. Në atë rast, kjo Marrëveshje do të përfundojë gjashtë (6) muaj pas marrjes së këtij njoftimi.

3. Secila Palë mund të anulojë këtë Marrëveshje duke njoftuar me shkrim depozitarin dhe palët e tjera. Në atë rast, Marrëveshja do të shfuqizohet për palën kërkuese gjashtë (6) muaj pas marrjes së njoftimit nga depozitari.

"Në dëshmi sa më sipër, nënshkruesit e autorizuar rregullisht nga qeveritë përkatëse kanë nënshkruar këtë Marrëveshje."

Bërë në_____,sot më_____2012, në një origjinal në gjuhën angleze.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Serbisë

.....

Ministri i Arsimit dhe i Shkencës

Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

.....

Në emër të Qeverisë së Republikës së Bosnjë-Hercegovinës

.....

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kroacisë

.....

Në emër të Qeverisë së Malit të Zi

.....

Në emër të Qeverisë së Republikës së Moldavisë

.....

Në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

.....

SHTOJCA I

GODINA,PAJISJET,SHËRBIMET FINANCIARE DHE KONTRIBUTE TË TJERA ZYRE OFRUAR NGA VENDI PRITËS

Neni 1

Godina dhe pajisjet

Vendi pritës duhet t'i vendosë në dispozicion Sekretariatit në përputhje me këtë Marrëveshje:

a) Godinën e Selisë së Sekretariatit, pronë e Republikës së serbisë, me sipërfaqe totale prej 40 m^2, e vendosur në Beograd. Godina përfshin dy zyra dhe një sallë konferencash.

b) Qeveria e vendit pritës do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përshtatjen dhe rinovimin në përputhje me nevojat e Sekretariatit.

c) Pajisjet në zyrë do të përfshijnë:

- 3 tavolina zyre;
- 3 karrige zyre;
- 1 tavolinë konferencash me 20 karrige;
- 3 kompjuterë (me monitorë, tastiera dhe mause);

- 3 printera lazer;
- 2 laptopa;
- 1 projektor;
- 1 fotokopje;
- 3 telefona me central;
- 1 faks;
- 3 kondicionerë;
- 3 bufe;
- 3 rafte me sirtarë;
- 1 tavolinë kafeje me 4 karrige;
- 3 tapete;
- 1 frigorifer;
- 1 aparat kafeje.

d) Vendi pritës do të sigurojë gjithë shërbimet e nevojshme për funksionimin e Sekretariatit duke përfshirë, por pa u kufizuar te linjat telefonike dhe përdorimi i internetit.

Neni 2

Mbështetja financiare

Vendi pritës, përveç kontributit të tij vjetor, duhet të ofrojë një sasi prej 20,000 euro mbi bazë vjetore për shpenzime operative të Sekretariatit.

SHTOJCA 2

Neni 1

SHTOJCA 3
BUXHETI VJETOR PËR PERIUDHËN 2011-2013

Llogaritja e kontributit vjetor të anëtarëve të ERI SEE në favor të ERI SEE (kostot totale dhe operative) është kryer në përputhje me metodologjinë e zhvilluar për kontributin në RCC[1]. Anëtarët e ERI SEE kategorizohen në katër grupe sipas niveleve të tyre të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) në bazë të fuqisë blerëse (BFB), si më poshtë:

Grupi	PBB në BFB, miliardë $[2]	Kontributi vjetor në € për Anëtarët
I	<10.0	€ 5.400
II	<50.0	€ 7.200
III	>50.0	€ 9.000
IV	>70.0	€ 14.400

- Për nënshkruesit e pranishëm, kontributi vjetor për periudhën 2011-2013 është: për Shqipërinë (Grupi II): 7.200 €; për Kroacinë (grupi IV): 14.400€; për Maqedoninë (grupi II): 7.200€; për Malin e Zi (grupi I): 5.400€; dhe për Serbinë (grupi III): 9.000€. Bordi Drejtues i ERI SEE në këshillim me ministrat e arsimit të anëtarëve të ERI SEE mund të përcaktojë një nivel tjetër kontributi pas periudhës fillestare prej tre vitesh.
- Vendi i ardhshëm pritës do të flokojë afërsisht 20.000€ për shpenzime operative të specifikuara në shtojcën 2, përveç kontributit të tij vjetor.
- Financime të tjera vjetore nga burime të tjera; 110.000€, nga të cilat 15.000€ janë për shpenzime operative, janë kontribute të pritshme për vitin 2011 nga Austria, Holanda dhe Zvicra.
- Shuma e kontributit vjetor e ndonjë pale tjetër të mundshme në të ardhmen, që i bashkohet këtij Memorandumi, përllogaritet në përputhje me metodologjinë e përmendur më lart dhe informacionin e kontributit të pritshëm, i cili formalisht u komunikohet ministrive kompetente të rajonit të ERI SEE.
- Duke supozuar dhjetë anëtarë, projektbuxheti vjetor i ERI SEE është 220.000€, nga të cilat rreth 75.000€ ndahen për kostot operative (Sekretariati i ERI SEE).

1 Metodologjia përfshin llogaritje të kontributit për një periudhë trevjeçare.
2 Prodhimi i brendshëm bruto në paritet/barazi të fuqisë blerëse. Burimi: FMN, tetor 2009

MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT
mbi rolin dhe organizimin e Nismës së Reformës në Arsim të Evropës Juglindore (ERI SEE)

Neni 2

Për Republikën e Moldavisë dhe Bosnjë-Hercegovinës që aderuan në Memorandumin e Mirëkuptimit nëpërmjet protokollove të nënshkruara nga ministrat përgjegjës të arsimit dhe kryetari i ERI SEE, përkatësisht më 27 dhjetor 2010 dhe 11 mars 2011, në përputhje me shtojcën 3 të Memorandumit të Mirëkuptimit, kontributi vjetor për periudhën 2011-2013 është:

- Moldavia 5,400.00 euro dhe
- Bosnjë-Hercegovina 7,200.00 euro